



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-32891/19
Kaçanik, 17.10.2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IX-të (Nëntë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur me, 17 Tetor 2019. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në ish-in 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj me arsye, Arlinda Rakoci-Raka.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive: Ramadush Osmani, Ukshin Qallaku, Festim Neziraj dhe Fatmir Loku, ndërkaq nga zyrtarët ish-in: Bejtulla Dalloshi, Fatlume Guri-Selimi dhe Iliriana Berisha.

Nga OSBE, mbledhjen e monitoroj, Faruk Dërmaku.

Mbledhja u monitorua përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, Procesmbajtës, Makfite Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, fillimisht iu njoftoj se në këtë muaj do të mbahen dy mbledhje të Kuvendit të Komunës(KK) për shkak se një njëra mbledhje e KK e planifikuar në muajin Korrik nuk e kemi mbajtur, kështu që e njëjta do të mbahet në këtë muaj. Në vazhdim konstatoj kuorumin duke i thirrur emër për emër të gjithë anëtarët e KK. Pjesëmarrës në mbledhje janë. 26 anëtarë, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e IX-të (Nëntë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës, për vitin 2019, data 17 Tetor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Draft- Rregullorja për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve; dhe
3. Draft Rregullorja për transparencë komunale.

Rendi i propozuar të punës u shtrua në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës.

APROVOJ

Rendin e Punës në përbërje prej 3 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës:

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

znj. Kaltrina Tafili, Të pozicioni, Pyetje dhe Kërkesa, Unë kam ngritur Kërkesën në emër të qytetarëve të “BK Centër” për zhurmën që po krijohet në rrugën “Ismajl Raka” në orët e vona, e jo si është shënuar në proces.

znj. Nazife Krasniqi, Të pozicioni, Pyetje dhe Kërkesa, Unë kam thënë që, mos vendosja e një “Laure” në vendkalimin hekurudhor, paraqet rrezik për nxënësit e shkollës FSHMU “Emin Duraku” paralelja në Dushkajë, e jo si është shënuar në proces.

z. Adnan Reka, Në lagjen “Avdyrrahim Shehu” unë kam thënë së nuk shoh se keni ndarë mjete financiare për këtë rrugë as për vitin 2020, as 2021, përveç se e keni futur si kod buxhetor. Meqë po thonë se keni planifikuar projekte në turizëm, a mund të me tregoni drejtor, sa mjete buxhetore janë ndarë për menaxhimin e mbeturinave në zonat turistike, derisa ju keni thënë se këtë vit i kemi shpallur luftë mbeturinave, për çfarë lufte po flisni, ne jemi gati në fund të vitit dhe nuk po shohim asnjë përmirësim të gjendjes së mbeturinave, apo ndoshta e keni lënë për natën e vitit të ri të bëni luftë me fishekë zjarre.

z. Ekrem Raka, Të diskutimi i buxhetit f. 4. pjesa e diskutimit tim është shënuar pak më ndryshe. Unë kam thënë: “Mënyra si po planifikohet buxheti i komunës, pothuajse është gati e njëjtë nga vitet paraprake, me disa ndryshime kozmetike”.

Kryesuesi i Kuvendit, Vërejtjet është mirë më i përcjellë edhe në email, ndërkaq me këto vërejtje, Procesverbalin e mbledhjes së VIII-të (Tetë) të Rregullt i Kuvendit të Komunës e shtroj në votim për aprovim. Rezultati i votimit është njëzëri “Për”. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja e VIII-të (Tetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2019 të datës 27 Shtator 2019 / Lënda: 01Nr. 60/01-30924/19.

Vërejtjet e 4 anëtarëve të KK do të futën në Procesverbal dhe Procesverbalin do të publikohet i përmirësuar.

Kryesuesi i Kuvendit, Para se me kaluar në pikët tjera të rendit të punës, nëse ka kush ndonjë pyetje apo kërkesë, lë të urdhëroj:

Pyetjet dhe Kërkesat

z. Ekrem Kyçyku, Kam një pyetje për DSHPE, Projekti për ndërtimin e rrugëve të qytetit. Ky projekt do të realizohet nga granti i përfutur i komunës. Me intereson të di, pse janë vonuar punimet e këtij projekti dhe kur do të realizohet ky projekt ?

z. Shemsedin Luzha, Unë kam një Njoftim për Kuvendin e Komunës, nga sot e tutje unë Shemsedin Luzha, në Kuvendin e Komunës do të veproj si “Anëtar i Pavarur” e jo në kuadër të “Grupit të Pavarur” që isha deri me tani.

z. Adnan Reka, Ka kohë që ne po kërkojmë masa sigurie (së paku, vendosjen e një laure) të kalimi hekurudhor për të SHFMU “Emin Duraku” te “Kisi”. Ju lëre që nuk po kujdeseni që të vendoset laura atje, por nga lënia e punëve të pakryera për shumë kohë si zakonisht, ju keni hapur edhe vendkalime tjera mbi hekurudhë të rrezikshme për nxënës. Përballë gjimnazit “Skënderbeu” ju keni rregulluar shkallët për të zbritur te parku, por nuk keni vendosur pengesa që gjimnazistët të mos e shfrytëzojnë atë kalim të rrezikshëm mbi hekurudhë për të kaluar më shkurt në shëtitoren e qytetit. Për më tepër, nga punët e pakryera dhe dëmtimi i shtyllave elektrike nga operatorët, të gjithë nxënësit e këtyre shkollave i keni lënë t’i kalojnë nëpër terr këto hekurudha të rrezikshme, ndoshta ju po e bëni me qëllim për të mos u vërejtur kalimi ilegal i hekurudhave nga nxënësit, ndërsa unë ju pyes, edhe sa do të zgjasë kjo pasiguri e fëmijëve tanë?

z. Selim Reka, Pyetja ime është: Një pjesë e trotuarit të SHM “Skënderbeu” deri të “Ura e Konakut” ka kohë që ka mbetur pa u shtruar. Më intereson të di, ku qëndrojnë arsyet dhe kur do të realizohen punimet e këtij projekti ?

z. Bekim Koxha, Kam një Kërkesë në emër të komunitetit Koxhaj për rrugën që shkon për në Brezovicë-Shterpçë, nuk ka siguri ajo pjesë dhe paraqet rrezik për fëmijët të cilët kalojnë atypari. Kërkesa e komunitetit është që, me bërë diçka në pjesën e vendkalimit, sa nuk është bërë vonë.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kërkesa të tjera, përgjigjet do t’i merrni nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhjen vijuese të Kuvendit të Komunës. Atëherë procedojmë me pikët e radhës të rendit të punës: Kalojmë në pikët vijuese sipas rendit të punës:

2. Draft- Rregullorja për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve:

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë me kohë, drejtorët e drejtorive janë prezent në mbledhje, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Draft Rregullorja është mirë e hartuar, ndërkaq ajo që po hasim sa herë në vështirësi, është zbatimimi i saj nga organet relevante zbatuese, si nga institucionet shkollore dhe institucionet tjera të përcaktuara. Këtë e themi sepse, fëmijët e moshës jo madhore në çdo kohë blejnë cigare, ndërkaq nuk e di sa ka me pasur mundësi kjo çështje të pengohet me këtë rregullore.

znj. Kaltrina Tafili, Unë iu përgëzoj për Draftin e hartuar të rregullores, ndërkaq të neni 4 pika 2.7 pasuesi: “Ecë sigurt rrugës së qytetit”, Komuna në aspektin e rreziqeve nuk ka

bërë asgjë, sepse nuk kemi trotuare në afërsi të shkollave, ndërkaq shkollat janë në afërsi të rrugëve, pastaj shumica e rrugicave janë pa trotuare. Tjetër, e kemi çështjen e "Laurës" që u përmend me u vendosur të kalimi hekurudhor e cila pjesë paraqet rrezik të vazhdueshëm për nxënësit etj. që kalojnë atypari, e kështu me radhë.

Kryesuesi i Kuvendit, Vërejtjet të cilat u potencuan, janë evidente, megjithatë Rregullorja duhet me gjetur zbatim në të ardhmen. Rregullorja përmban shumë çështje të cilat janë në obligim të organeve të komunës me u përmbushur.

z. Ekrem Raka, Unë mendoj që pjesa që na takon neve si Kuvend i Komunës duhet të kujdesemi për me u realizuar, ndërkaq për pjesën e cila nuk na takon neve, janë organet përgjegjëse të përcaktuara si në rregullore, të cilat duhet kujdesën për realizimin e tyre.

Kryesuesi i Kuvendit, Në mbledhjen vijuese të KK do të formojmë një komision për hartimin e Planit të Punës së KK për vitin 2020. Në atë plan do të parashohim që në dy mbledhje me u debatuar çështja e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

z. Ekrem Kyçyku, Unë kam dhënë propozim në KPF që në Draft Rregullore të përmendet "Ndalimi i punës së fëmijëve nën moshën 16 vjeç" kur dihet se puna e fëmijëve nën këtë moshë është e ndaluar me rregulla ligjore, mirëpo propozimi im nuk është përfillur.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë Draft Rregullore e shtroj në votim për aprovim; Rezultati i votimit është njëzëri Për. Në saje të kësaj del konstatimi së, Kuvendi i Komunës mori vendim më të cilën e,

APROVOJ

Rregulloren për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve / Lënda 01Nr. 02-60/01-31844/19.

3. Draft Rregullorja për transparencë komunale:

Kryesuesi i Kuvendit, Edhe për këtë pikë materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin

z. Adnan Reka, Do të doja të dija në cilat forume apo institucione publike janë diskutuar dhe konsultuar këto rregullore para se t'i sillni në Kuvend për miratim. Përkufizimi Nr. 7, i kësaj rregullore thotë: Konsultimi publik i akteve komunale – nënkupton seancën dëgjimore dhe marrjen e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të publikut para miratimit të saj. Ndërsa ne po miratojmë vetë Rregulloren për Transparencë Komunale pa asnjë seancë dëgjimore paraprake dhe pa asnjë propozim të publikut, gjë për të cilën jemi të obliguar nga kjo rregullore dhe akte tjera ligjore.

Kryesuesi i Kuvendit, Çdo akt që miratohet në KK e që është në interes të përgjithshëm të qytetarëve të komunës, duhet t'iu nënshtrohet procedurave të Debatit publik me qytetarë. Rregullorja ka qenë në dëgjim publik ashtu si e parashohin rregullat ligjore në fuqi, ndërkaq a ka pasur të interesuar me marrë pjesë në atë dëgjim publik, është çështje tjetër. Njoftimi publik ka ekzistuar për dy rregulloret dhe këto akte nuk mund të aprovohen në KK pa kaluar këtë procedurën e debatit publik me qytetarë.

z. Festim Neziraj-drejtor i DAP, lu njoftoj se dy rregulloret kanë qenë në dëgjim publik me qytetarë. Dy rregulloret janë mostër që janë hartuar nga ekspert të niveli qendror. Si dëshmi së këto dy rregullore kanë qenë në dëgjim publik me qytetarë janë: Procesverbalet, ndërkaq çështja sa kanë se sa ka pasur të interesuar me marrë pjesë në dëgjimet publike të organizuara është tjetër. Në Draft Rregullore janë futur vërejtje dhe propozimet e dala nga Dëgjimet publike. Me 22 Tetor është organizuar Dëgjim publik edhe për Draft Rregulloren e Tarifave dhe Ngarkesave. Nëse këto dy rregullore bien ndeshë me ligjet në fuqi, atëherë do të merren parasysh dispozitat e ligjeve përkatëse në fuqi.

z. Adnan Reka, Mendoj se është dashur që, me materialin e mbledhjes më na i dërguar edhe materialin e debateve publike me qytetarë për dy Draft Rregulloret e propozuara, në mënyrë që të dimë për forumet në të cilat janë debatuar këto rregullore.

Kryesuesi i Kuvendit, Më rëndësi është që për dy rregulloret janë mbajtur dëgjime publike me qytetarë, ndërkaq në dëgjimet publike dihet së jemi të obliguar edhe ne si KK të marrim pjesë. Për kërkesat të cilat kanë dalë nga dëgjimet publike, janë procesverbalet dhe ata që janë të interesuar mundën me i pa të njëjtat, ndërkaq në draft rregullore nuk mund të potencohet çështja e kërkesave të dala nga dëgjimet publike, kush çka ka propozuar. Atëherë, meqë nuk ka kush diçka tjetër, Draft Rregulloren për transparencë komunale e shtroj në votim për aprovim. Rezultati i votimit ishte njëzëri. Për. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori vendim me të cilin e,

APROVOJ

Rregulloren për transparencë komunale/ Lënda: 01Nr. 02-60/01-31847/19.

Në fund, Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, kërkoj nga shefat e grupeve parlamentare dhe kandidatët e pavarur që veprojnë në KK, që pas mbledhjes së KK të ndalën në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit, ashtu që të bisedojmë për organizimin e një vizite në Shqipëri. Të debatojmë për kohën dhe Agjendën, ashtu që të shikojmë se a do të formojmë një grup punues për vizitat që do t'i bëjmë në dy apo tri Bashki të Shqipërisë. Vizita është për të gjithë anëtarët e KK.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit i njoftoj anëtarët e KK për një punëtori dy ditore të organizuara nga DEMOS. Trajnimi është për të gjithë anëtarët e KK, do të mbahet me datë 12 dhe 13 Nëntor, në restorant "Astoria". Qëllimi i trajnimit është, ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të KK dhe shkëmbimit të përvojave me komunat tjera, për një funksionim më të mirë të KK.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e kuvendit të përfunduar. Ora e përfundimit të mbledhjes, 11:30. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 26 anëtarët sa ishin prezent në mbledhje në fillim.

Procesmbajtës

Makfite Malsiu

Makfite Malsiu



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2017);

nga Mbledhja e IX (Nëntë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2019, mbajtur me 17 Tetor 2019.

1. Kemal Mërseli..... _____,
2. Hamid Guri..... _____,
3. Ahmet Luma _____,
4. Kadri Krivenjeva,..... _____,
5. Besim Vishi,..... _____,
6. Sali Malsiu..... _____,
7. Lirije Shurdhani..... _____,
8. Pranverë Loku- Zharku..... _____,
9. Lirije Luta..... _____,
10. Vlora Dallosi..... _____,
11. Nexhat Loku _____,
12. Shpend Krusha..... _____,
13. Adnan Reka..... _____,
14. Ekrem Kyçyku..... _____,
15. Fatijona Kyçyku..... _____,
16. Kaltrina Tafili _____,
17. Selim Reka..... _____,
18. Besnik Salihu,..... _____,
19. Nazife Krasniqi..... _____,
20. Arlinda Rakoci-Raka..... _____,
21. Shemsedin Luzha..... _____,
22. Albana Troni..... _____,
23. Afërdita Shehi,..... _____,
24. Hajredin Luta..... _____,
25. Hafize Sallahi _____,
26. Bekim Koxha..... _____,
27. Ekrem Raka,..... _____,



Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 30. 10. 2019

Për: Anëtarët e Kuvendit: z. Ekrem Kyçyku,
z. Adnan Reka,
z. Selim Reka,
z. Bekim Koxha

Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruara para Kuvendit të Komunës, më datë 17. 10. 2019, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

z. Ekrem Kyçyku, Kam një pyetje për DSHPE, Projekti për ndërtimin e rrugëve të qytetit. Ky projekt do të realizohet nga granti i përfituar i komunës. Me intereson të di, pse janë vonuar punimet e këtij projekti dhe kur do të realizohet ky projekt ?

- *Projekti “Ndërtimi dhe rregullimi i rrugëve të qytetit” projekt që është duke u realizuar nga mjetet e perfituara nga Grandi i Performances në bashkëfinancim me mjetet e buxhetit komunal është në fazën finale të punimeve. Aktualisht është duke u rivendos ndriçimi publik dhe punimet finale në ndërtimin e trotuarit përgjatë pjesës së parkut të qytetit.*

z. Adnan Reka, Ka kohë që ne po kërkojmë masa sigurie (së paku, vendosjen e një laure) të kalimi hekurudhor për të SHFMU “Emin Duraku” të “Kisi”. Ju lëre që nuk po kujdeseni që të vendoset laura atje, por nga lënia e punëve të pakryera për shumë kohë si zakonisht, ju keni hapur edhe vendkalime tjera mbi hekurudhë të rrezikshme për nxënës. Përballë gjimnazit ‘Skënderbeu’ ju keni rregulluar shkallët për të zbritur te parku, por nuk keni vendosur pengesa që gjimnazistët të mos e shfrytëzojnë atë kalim të rrezikshëm mbi hekurudhë për të kaluar më shkurt në shëtitoren e qytetit. Për më tepër, nga punët e pakryera dhe dëmtimi i shtyllave elektrike nga operatorët, të gjithë nxënësit e këtyre shkollave i keni lënë t’i kalojnë nëpër terr këto hekurudha të rrezikshme, ndoshta ju po e bëni me qëllim për të mos u vërejtur kalimi ilegal i hekurudhave nga nxënësit, ndërsa unë ju pyes, edhe sa do të zgjasë kjo pasiguri e fëmijëve tanë?

- *Qështja e nevojës së vendosjes së një laure në afërsi të objektit të ETC-së të kryqëzimi i rrugës “Skenderbeu” dhe “Emsale Frangu” është adresuar si kërkesë Drejtorisë së Hekurudhave të Kosovës , pasi që kjo është në përgjegjësi të këtij organi, me theks të*

veçant rrezikun potencial gjatë kalimit të nxënësve që gravitojnë këtë segment rrugor gjatë shkuarjes dhe kthimit të tyre në shkollë.

Punimet në rrugët e qytetit, ndriçim dhe trotuarit përgjatë pjesës së parkut të qytetit janë në përfundim. Janë duke u krijuar hapësira të zgjeruara dhe të sigurta për qarkullim të këmbësorëve dhe vendosja e shenjzimit horizontal dhe vertikal (vendkalime për këmbësor, tabela orientuese dhe informuese) si dhe do të merren edhe masat tjera të nevojshme për sigurinë e qytetarëve në këto hapësirat publike.

z. Selim Reka, Pyetja ime është; Një pjesë e trotuarit të SHM “Skënderbeu” deri të “Ura e Konakut” ka kohë që ka mbetur pa u shtruar. Më intereson të di, ku qëndrojnë arsyet dhe kur do të realizohen punimet e këtij projekti ? .


- *Pjesa e mbetur pa shtruar në pjesën e trotuarit përgjatë parkut të qytetit është ndërprerë shkak i instalimeve nëntokësore të rrymës dhe pritjes së pëlqimit nga KEDS-i për zhvendosjen e shtyllave elektrike dhe ormaneve që ndodhen në atë hapësirë. Pas sigurimit të pëlqimit nga ky organ është filluar me finalizimin edhe të kësaj pjese të trotuarit.*

z. Bekim Koxha, Kam një Kërkesë në emër të komunitetin Koxhaj për rrugën që shkon për në Brezovicë-Shterpcë, nuk ka siguri ajo pjesë dhe paraqet rrezik për fëmijët të cilët kalojnë atypari. Kërkesa e komunitetit është që, me bërë diçka në pjesën e vendkalimit, sa nuk është bërë vonë.

- *Udhëkryqi i rrugëve rajonale Brezovicë dhe Tetovë me rrugët lokale në vendin e quajtur “Te Lushi”, është e vërtetë që ka një qarkullim të dendur të automjeteve dhe këmbësorëve. Pasiqë rrugët rajonale dhe ato magjistrale janë në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës në kemi kërkuar nga ky organ që të ndërmerr masat për vendosjen e shenjzimit rreth kufizimit të shpejtësisë dhe do të shqyrtojmë mundësinë e vazhdimin të trotuarit nga pishina “Natyra” deri në Fushë të Pajtimit, kurse rreth rrugëve lokale, tani në buxhetin komunal të vitit 2020 është paraparë rregullimi i trotuarit në rrugën “Kemal Kolshi”, si dhe kemi hartuar projektin për ndërtimin e trotuarit në rrugën “Ramadan Xhokli”*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,


Ramadush Osmani
Drejtor i DSHPE-së